

## **KËRKESË PËR BASHKËPUNIM**

Komisioni i Posaçëm për dhënien e licencave profesionale në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, që funksionon pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është duke proceduar rastin e paraqitur për parregullsi gjatë ushtrimit të aktivitetit të një individi të licencuar në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme. Për trajtimin e këtij rasti, Komisioni ka nevojë për ekspertizë dhe mendim të thelluar profesional.

Përsa më sipër, kërkohet bashkëpunim, për ngritjen e një grupi pune, me specialist të fushës, me qëllim verifikimin e e parregullsive të konstatuara dhe dhënien e mendimit të specializuar, bazuar në nenin 5/3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 12.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme”.

Individët që shprehin interes, duhet të plotësojnë këto kriteret:

- Të zotërojnë licencë profesionale individuale të vlefshme, për ushtrim veprimtarie në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme;
- Të kenë 5 vjet eksperiencë në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme;
- Të mos jetë marrë masë kundrejt licencës që zotërojnë në këtë fushë dhe të mos jenë të dënuar nga organet e gjyqësorit në lidhje me ushtrimin e profesionit të vlerësuesit.

Të interesuarit, për shprehjen e interesit të kontaktojnë me personel të Monitorimit të Lejeve dhe Licencave në Ndërtim, në Drejtorinë e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit, brenda 14 ditësh nga njoftimi zyrtar në faqen eMIE.